**Живот со Предизвици / Jeta me Sfida / Life With Challenges**

# Granulomatoza e Wegener

МКБ M 31.3 / Wegener's granulomatosis




Nocioni

Granulomatoza e Wegener (sëmundja e Wegener, granulomatoza me polangjit) paraqet një formë të rrallë të vaskulitit. Besohet të jetë një sëmundje autoimune ku më së shpeshti pësojnë qelizat endoteliale të cilat mbështjellin enët e gjakut nga brenda.

Granulomatoza e Wegener është një sëmundje multisistemike që mund të prek pothuajse të gjithë organet. Ndryshimet më të shpeshta patologjike vërehen tek organet ENT-vesh-hundë-fyt (gati 100%), në mushkëri (në një numër të madh të pacientëve) dhe në veshka (në 75% të rasteve). ).

Gjithashtu shpesh preken nyjet (deri në 50% të rasteve), si dhe sytë dhe lëkura. Nëse tek ndonjë person nuk janë përfshi veshkat, truri ose zorrët, atëherë besohet se ka një formë "të kufizuar" të granulomatozës së Wegener. Megjithatë, edhe në këtë formë të granulomatozës, polangjiti mund të jetë shumë i rëndë.

**Shkaqet**

Ende nuk dihet se çfarë e shkakton mekanizmin autoimun të sëmundjes së Wegener. Mendohet se inflamacioni mund të çojë në inflamacion sistemik, okluzion vaskular dhe granuloma. Një faktor që inicion këtë kaskadë mund të jetë një infeksion, siç është një infeksion me parvo-virus ose Staphylococcus aureus.

**Живот со Предизвици / Jeta me Sfida / Life With Challenges**

Disa nga simptomat më të rëndësishme të kësaj sëmundje janë:

- Sinusiti dhe hunda me rrjedhje;
- Kollë, dhimbje në gjoks dhe gulçim;
- Formimi i një abscesi në mukozën e hundës,
- Inflamacioni i veshit;
- Konjunktiviti dhe inflamacionet e tjera në sy;
- Ethet dhe djersitjet e natës;
- Humbja e oreksit dhe humbja e peshës;
- Dhimbje në nyje;
- Prania e gjakut në urinë.

Në raste të rralla, një zemër e kompromentuar mund të ndodhë, duke çuar në perikardit ose lezione në sistemin koronar ose nervor që çojnë në simptoma neurologjike.

Përveç kësaj, pacientët me këtë sëmundje kanë një tendencë të rritur për të zhvilluar trombozë, andaj vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet simptomave që tregojnë këtë ndërlikim, të tilla si ënjtje dhe skuqje të gjymtyrëve.

Mjeku mund të konfirmojë ose mohojë diagnozën pas një biopsie.

Bërja e një diagnoze të sëmundjes së dyshuar të Wegener përfshin:

- Analiza klinike dhe biokimike e gjakut;
- Testet e urinës;
- Ekzaminime me rreze X (imazhet e gjoksit);
- Biopsia e lëkurës, mushkëritë, veshkat;
- Ekzaminimet endoskopike
- Tomografia e kompjuterizuar.

**Trajtimi**

Trajtimi i granulomatozës së Wegener mund të ndahet në dy faza:

- arritja e remizionit
- mirëmbajtje te remizinit.
- Barnat kryesore në regjimin e trajtimit janë ilaçet citotoksike:
- Ciklofosfamidi (citoxan);
- methotrexate;
- Azathioprine (Imuran);
- Mikofenolatmofetil;
- Glukokortikosteroidet (prednizoni).
- Ndërsa ndërhyrja kirurgjikale mund të kërkohet në
- Deformime të hundës;

**Живот со Предизвици / Jeta me Sfida / Life With Challenges**

- Stenoza e laringut;
- Obstruksion i kanalit lacrimal;
- Bronhijalnastenoza;
- Dëmtim i veshkëve (transplatim)

Plani i trajtimit për secilin pacient përgatitet individualisht, sipas formës së sëmundjes, ashpërsisë së manifestimeve dhe terapisë përgjegjëse.

Është e pamundur të kurohet granulomatoza e Wegener, por diagnoza e hershme dhe trajtimi efektiv ndihmojnë në arritjen e remizionit dhe kthimit të jetës normale.

Remizioni afatgjatë arrihet dhe mbështetet nga administrimi i dozave të duhura të ilaçeve, diagnozë të rregullt dhe puna e përbashkët e mjekut dhe pacientit. Ndonjëherë remizioni mund të zgjasë deri në 20 vjet dhe në të njëjtën kohë një person nuk do të ketë nevojë të marrë ilaçe citotoksike dhe hormone.

Parashikimi

Besohet se te pacientët me polangjit granulomatoz rreziku i vdekjes në vitin e parë të sëmundjes është 9 herë më i lartë se tek njerëzit e shëndetshëm. Shkaku i vdekjes mund të jetë infeksioni apo dështimi i veshkave.

Me cilin mjek të kontaktoni?

Zakonisht, pacientët me manifestimet e para të Wegener-ogranulomatosis takohen me një specialist të ENT i cili i dërgon ato te një reumatolog. Me përfshirjen e organeve të tjera takime për konsultim caktohen dhe me një okulist, nefrolog, gastroenterolog, pulmonolog, dermatolog, neurology dhe imunolog. Vetëm tretman gjithëpërshirës mundë të shkaktojë remizion të sëmundjes dhe të ruajë cilësinë e jetës së pacientit.